



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.545/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kushtrim Zuka, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Drilon Konjufca, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosove, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli A.nr.545/2021, i datës 02.03.2021, i parashtruar nga Drilon Konjufca, me vendbanim në Gjermani, për mos konfirmim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosove, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021.

A r s y e t i m

Me datë 02.03.2021, PZAP-i ka pranuar një apel të parashtruar nga Drilon Konjufca të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 03 shkurt 2021, me të cilin thekson se nuk është përfshirë në listën e votimit përmes postës të publikuar nga KQZ. Ka aplikuar me 14 janar 2021, për votim me postë duke dërguar në emailin zyrtar aplikacionin dhe letërnjoftimin e Kosovës. Ka bashkangjitur edhe dokumente të komunikimit me KQZ-në.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Drilon Konjufca e dorëzuar nëpërmjet postës me datën 04 shkurt 2021, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar nga Drilon Konjufca të paraqitur me datën 03.02.2021 kundër KQZ-së e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 192/2021 të datës 05.02.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se apeli i parashtruar nga Drilon Konjufca është çështje e gjykuar “res iudicata”.

Megenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 192/2021 të datës 05.02.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.545/2021 më datën 03.03.2021

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.